



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 1159 Prot

Shkodër, më 18 08 .2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi “Për kalimin e mjetit ambulancë tek Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, për Qendrën Shëndetësore Dajç”.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për kalimin e mjetit ambulancë tek Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, për Qendrën Shëndetësore Dajç”.

Projekt- vendimi është paraqitur pranë Këshillit Bashkiak me shkresën me Nr.1182 Prot., datë 25.01.2023. Është shqyrtuar në mbledhjen e KB të muajit mars, por nuk është miratuar për mungesë kuorumi. Po e risjellim pasi nuk është shqyrtuar për shkak të periudhës zgjedhore dhe periudhës tranzitore për bashkinë Shkodër për shkak të konstituimit të Këshillit të ri bashkiak dhe fillimit të punës së Kryetarit të ri të Bashkisë.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet Beci

Me vendim delegimi

Zv/Kryetar
Onid Bejleri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2023

“PËR KALIMIN E MJETIT AMBULANCË TEK NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR SHKODËR, PËR QENDRËN SHËNDETËSORE DAJÇ”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja “e”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit Nr. 10 138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”; Ligjit Nr.10 107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; VKM -së Nr.405, datë 20.5.2020 “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në shqipëri 2020-2025”; VKM –së Nr. 210, datë 6.4.2022 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të shëndetësisë 2021-2030”; VKM-së Nr. 866, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”; Udhëzimit Nr.30, datë 27. 12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Udhëzimit Nr.1, dt. 03.01.2018 “Mbi operacionet e privilegjuara”, i ndryshuar; Aktit të dhurimit nr. 17905 prot. Datë 30.11.2022 mes Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës Confraternita MISERICORDIA CASALGUIDI E CANTAGRILLO ODV-ETS, procesverbalit të marrjes në dorëzim me nr 18144/2 prot, datë 09.12. 2022, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkoder me nr _____ prot, date ____ . ____ . 2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë kalimin e mjetit ambulancë FIAT – DUCATO – telaio, me Nr. shasie ZFA 25000001058810, me vlerë 116,860 lekë tek Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, për Qendrën Shëndetësore Dajç.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

Me vendim delegimi

Zv/Kryetar

Onid Bejleri



*Drejtorja e Shërbimeve
Sociale dhe Strehimit*

Josua Bodele

Drejtorja Juridike

21

*Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve Mbështetëse*

Drejtorja e Financës

Blerta Pjoshi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

RELACION

“Për kalimin e mjetit ambulancë tek Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, për qendrën shëndetësore Dajç”.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar Këshilltarë!

Shqipëria aktualisht po përballlet me një sërë reformash të rëndësishme në nivel kombëtar dhe vendor lidhur me sistemin shëndetësor. Dokumentet strategjike të rëndësishme në këtë kuadër janë: Strategjia e zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri 2020-2025, miratuar me VKM Nr.405, datë 20.05.2020 dhe Vendim Nr. 210, datë 6.4.2022 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të shëndetësisë 2021-2030”;

Strategjia e Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP) në Shqipëri ndërtohet për herë të parë, por është hartuar mbi një traditë të mirëkonsoliduar tashmë. Në të pohohet se pjesa dërrmuese e kontakteve që popullsia ka me sistemin shëndetësor realizohen në nivelin e Qendrave Shëndetësore dhe shumë probleme shëndetësore trajtohen nga mjekët e përgjithshëm ose edhe infermierët në strukturat e kujdesit shëndetësor parësor. Pavarësisht kësaj, ndryshimet demografike dhe epidemiologjike, pritshmëritë gjithnjë në rritje ndaj kujdesit shëndetësor, së bashku me rreziqet e larta të shtimit të pabarazive, kërkojnë më shumë mbështetje, përshtatje dhe reforma në kujdesin shëndetësor parësor. Kjo strategji do të përcaktojë rrugën e përgatitjes së sistemit të kujdesit shëndetësor parësor që do të adresojë në mënyrë më të mirë dhe efikase nevojat shëndetësore e të gjitha komuniteteve dhe kategorive të popullatave. Sipas saj, do të krijohen modele të reja shërbimesh për të mbuluar nevojat më urgjente që janë identifikuar në nivel komuniteti, të tilla si parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve jo të trasmetueshme (SJT), shërbimi i kujdesit në familje për të moshuarit, modelet e kujdesit përmes teknologjisë digjitale, veçanërisht në zonat e thella, etj.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, një nga politikat dhe objektivat e Bashkisë Shkodër, është përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promovimit shëndetësor në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimi e sëmundjeve, si dhe ndërtimi, rehabilitimi, mirëmbajtje e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor.

Në vazhdimësi të përpjekjeve dhe nismave të Bashkisë Shkodër dhe në përputhje me objektivin specifik 3 i politikës 1, të strategjisë së zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri 2020-2025, miratuar me VKM Nr.405, datë 20.05.2020, për të kontribuar në mënyrë aktive në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të komuniteteve të saj dhe fuqizuar bashkëpunimit midis Operatorit dhe NJQV lidhur me koordinimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale që ofrohet në nivel Bashkie me atë që ofrohet në nivelin e qendrave të kujdesit shëndetësor do të realizohet kalimi i mjetit ambulancë nga përfituesi i ambulancës që është: Bashkia Shkodër, me përdorues: Njësia Administrative Dajç tek Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, qendra shëndetësore Dajç”.

Kjo ndërhyrje zhvillohet paralelisht dhe në përputhje të plotë edhe me strategjinë kombëtare të shëndetësisë 2021-2030, e cila ka për qëllim vazhdimin e përpjekjeve për të përmirësuar shëndetin, mirëqenien e popullatës duke respektuar të drejtat e tyre për shëndet të mirë gjatë viteve 2021-2030. Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë, 2021-2030 mbështetet në vizionin e shëndetit, misionin e tij, parimet e shëndetit dhe vlerat themelore të shëndetit.

Kjo ndërhyrje ka për qëllim përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve në përgjigje të nevojave shëndetësore të komunitetit të Bashkisë Shkodër.

Zona e Dajçit duke qënë një zonë e rrezikuar nga përmbytjet ka më se të domosdoshme rritjen e kapacitetit të personelit shëndetësor duke pasur në dispozicion edhe një mjet ambulancë në shërbim të tij për të përmirësuar përgjigjen në kohë dhe sipas standardeve të ofrimit të kujdesit shëndetësor parësor për komunitetin e Njesisë Administrative Dajç.

Ky dhurim u bë i mundur në sajë të bashkëpunimit me shoqatën Confraternita Misericordia Casalguidi e Cantagrillo Odv-Ets për rastet e emergjencave shëndetësore të komunitetit, për ofrimin e një shërbimi shëndetësor cilësor për komunitetin e Njesisë Administrative Dajç.

Donacioni u konkretizua përmes marrëveshjes së bashkëpunimit (akt dhurimi) midis Bashkisë Shkodër dhe shoqatës Confraternita Misericordia Casalguidi e Cantagrillo Odv-Ets me Nr. 17905 Prot. Datë 30.11.2022 dhe u mor në dorëzim nga Bashkia Shkodër me procesverbalin me nr 18144/2 prot, datë 09.12. 2022,

Sa më lart propozojmë para Këshillit Bashkiak të miratojë:

kalimin e mjetit ambulancë FIAT – DUCATO – telaio, me Nr. shasie ZFA 25000001058810, me vlerë 116,860 lekë tek Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, për Qendrën Shëndetësore Dajç.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Benet Beci

Me vendim delegimi

**Zv/Kryetar
Onid Bejleri**



Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik

Lorena Bardeli